# ANKESE

*Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

**Për:** **Komuna e Kamenices**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

| | |
|---|---|
| **Nr1 i prokurimit** | **KM653-23-8454-5-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | |

Sa i përket tenderit për: **NDERTIMI I BULEVARDIT NE KAMENICE -PUNET E MBETURA-RITENDERIM 2**

## 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

***Engineering RK Sh.p.K. & GASHI ING Sh.P.K.***
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

***Rr, Hoxhe Jonuzi-***
(Adresa)

**Viti**
(Vendi)

**61000**
(Kodi postar)

**044 193 906**
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

**Reshat Kamberi**
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

***engineering_viti@hotmail.com***
(Adresa elektronike)

***02.10.2023***
*(Data e parashtrimit të kërkesës)*

SH.P.K. ENGINEERING RK VITI

*(Nënshkrimi dhe vula)*

## 2. Identifikimi i avokatit

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

*(Emri i avokatit)*

*(Adresa e plotë)*

*(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)*

*(Adresa elektronike)*

*(Data e parashtrimit të kërkesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

**3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit**

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

Njoftimi për kontratë: 10.08.2023
Hapja e ofertave: 21.08.2023
Njoftimi mbi vendimin e AK: 12.09.2023
*Kerksa per ri-shqyrtim: 16.09.2023*
*Vendimi i kerkeses per ri-shqyrtim: 21.09.2023*

**4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet**

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po Jo x

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** ***nëse aplikohet***

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po x Jo

**6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për*

*Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**NENI 1**
**NENI 7**
**NENI 59**
**NENI 69**
**NENI 70**

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

Pase qasjes ne dokumentacion e ketij tenderi kemi verejten se grupi i OE ne koncersium i shpallun fitues eshte i pa pergjegjshem ne shume pika.

**Pretendimi 1.** Gjate krijimit të grupit të OE konform nenit 87, paragrfi 2, nen paragrafi 2.8 te ligjit 04/L042 per prokurimi publik i ndryshuar dhe plotesuar me Ligjin 04/L-237 Ligji 05/L-068 dhe Ligjin 05L/092 te RROUP të rregullave per Grupin e Operatorve Ekonomike te percaktuar me nin 71 i LPP-se dhe neni 26 i rregullores Nr. 001/2022, ne raste se OE vendosin te tenderojn ne grup Grupi i OE duhet te dorezoj se bashku me tenderin e tyre mareveshjen per themelimin e grupit ne paragrafet 2 dhe 3 te nenit 71 te LPP-se si dhe ne FTD ( Fleta e te dhenave te tenderit) te dosjes se tenderit kerkohen tri deklarata qe duhet te plotesohen nga Grupi i OE si ne vijim:

a. **Nje deklarat e qarte ku gjithe antaret e grupit jane bashkarisht** dhe individualsiht pergjegjes per permbajtjen e grupit te tenderit
b. **Nje deklarat te nenshkruar** nga secili antare duke konfirmuar pjesmarrjen e tyre ne grupe se ata nuk jane duke marre pjes ne menyre individuale apo ne ndonje grup tjeter qe marrin pjese ne proceduren e njejt te prokurimit
c. **Nje deklara te nenshkruar nga gjith antaret e grupit te cilet e autorizojn partnerin kryesore** per te vepruar ne emer te grupit.

Grupi i OE i shpallun fitues NUK i ka plotesuar keto kerkese siq duhet.

**Pretendimi 2.** Grupi i OE lideri i grupit Varna Sh.P.K. nuk e ka asnje pune te ngjashme dhe nuk permbush kushtin per 51% pune te ngjashme

**Pretendimi 3.** ISO e kerkuara i ka ta te prezentuar vetem lideri Varna Sh.P.K. ndersa antaret e grupit nuk i kane, konform rregullores A01/2022 neni 26.6 ku gjithe antaret veq e veq duhet te plotesojn kushtin per standardin e cilese dhe ne kete pike Grupip i OE ka deshtuar te plotesoj

**Prentendimi 4.** Ingjinjeri i ndertimit z. Feriz Terstena i njejti ka maredhnje pune me Insticione publike ( profesore ne shkollen e mesme teknike ne Gjilan ) me norme te plote 40 ore ne jave dhe te njejtin ky grup i OE e ka prezentuar si ing i hidros me kontrate te plote ne 40 ore ne jave. Ne baze te ligjit te punes nje person jurudik nuk munde te jete me orar te plote ne te njejten kohe ne dy pune. Primare

**Prentendimi 5.** Ne njoftimin per kontrate eshte kerkuar vetem nje gjeodete ndersa Grupi i OE ka prezentuar 2 ingjinjer te gjeodezise, gjeodeti i prezentuar me kontrate ka diplome ne Universitetin e Sarajeves por nuk e ka paraqit nostrefikimn e diplomes i cili ka qen kusht ne DT, ingjinjer tjeter i

prezentuar me kontrate me OE ne koncersium Bageri Company nuk ploteson kushtin 5 vite pervoj pas diplomimit me cka nenkupton se ky kusht nuk eshte plotesuar nga Grupi i OE ne koncersium.

**Konstatimi1.** per OE nuk qendrojn nga AK-ja dhe kete e kemi deshmuar me argumente ne kerkesen per ri-shqyrtim mirpo AK-ja nuk i ka marre parasyshe,
Konstatimi1. Plani Dinamik- Edhe ne kerkesen per sqarim permese deklarates se Grupit te OE kemi deklaraur se ka qen leshim teknik ( devijim i vogel ) nga ana e ingjinjerit dhe permes kesaj deklarate jemi zotuar se mbrenda 120 diteve do ta permbyllim projektin, me kerkesen per ri-shqyrtim kemi dorezuar edhe planin dinamk te ri me 120 kalendarike, edhe pse ju si AK nuk e keni kerkuar ne kerkesen per sqarim te tenderit planine ri dinamik por vetem keni kerkaur deklarim
**Konstatimi 2.** Sa i perket kontratave/ referncave te natyres se njejt ne si koncersium kemi ofruar mbi 50 kontrata te natyres se njejt te cilate jane te ngarkuare ne e-prokurim,
Konstatimit 3. Menagjeri i projektit nuk ka te menagjuar projekte te natyrese se ngjashme kjo nuk qendron siq e kemi argumentar edhe ne kerkesen per ri-shikim z. Emin Rexhepi ka refernca te kesaj natyre psh. Ne projektin Renovimi i shtepise se kultures ne Viti ku menagjer ka qene z. Rexhepi eshte ndertu platoja prej 560m2 nga graniti natyral me trashesi 3cm, pastaj Nderimi i shkolles ne lagjen Malesia Kamenic, platoja para shkolle, dhe gjitha shkollat tjera ku ka qen menagjer z. Rexhepi secila nga to ka pase kubeza te betoni, dhe ne nuk kemi leshu refernce per secilin aktivitet te kontrates por referenca eshte leshuar me emer te projekti qe nenkupton edhe punet e cekura me larte dhe si i till ky konstatim nuk qendron dhe z. Rexhepi ka pervoj te madhe dhe i ploteson te gjitha kerkesat e DT.
**Konstatimi 4.** Nuk qendron aresyetimi i AK-se se nuk kemi vendime per stafin e angazhuar sepse te gjithe jane me mareveshje ne emer te projektit dhe te noterizuar ne prani te kompanise dhe ingjinjerave. Dhe nuk munde te nxerrim vendim kur te njejten kohe kemi mareveshje angazhimi me emer projekti. Ky kusht eshte i plotesuar nga ana e jone.
**Konstatimi 5.** Ing i gjeodezie i cili ka mbaruar studimet per master ne Tirane, i kemi dorezuar ne kerkesen per ri-shqyrtim kopjen e mareveshjes Kosov – Shqiper e vitit 2021 me te cilen njihen diplomat ne dy shtete respektive.
**Konstatimit 6.** I kemi sqauar AK-se se cmimet per fontanat jane te liferuar kohe me pare ne depot e liderit Gashi ing, dhe oferta jone si tersi eshte vetem 8% e parashikuar nga AK-ja.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së, sepse e keni rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të papërgjegjshëm.

Gjithashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi por po shihet se qëllimi i juaj është që ne mos të shpallemi fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Në fund kërkojmë nga OSHP që të nxjerrni:

| |
|---|
| **VENDIM**<br>**APROVOHET**, si e bazuar ankesa e grupit të OE Engineering RK Sh.P.K. dhe Gashi Ing Sh.P.K.<br>**ANULOHET,** njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhe lënda kthehet në **RI-VLERSIM** dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.<br><br>Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente. |
| |

**8. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, në vlerë prej 50,000.00 euro.

**9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

a. *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b. *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c. *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
d. *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*